



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJËSJELLËS DHE KANALIZIM
REGULATORNI URED ZA VODU I KANALIZACIJU
WATER AND WASTEWATER REGULATORY OFFICE



RAPORT PERIODIK VLERËSIMI

MBI PËRMBUSHJEN E CAQEVE TË PËRCAKTUARA

ME PROCESIN TARIFOR 2012-2014

ANALIZA: 9 mujore e vitit 2012

Vjetore 2012

Viti 2012

Prishtinë, Dhjetor 2012

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efëiente të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Misioni

“Rregullimi efektiv, transparent i shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, në pajtim me praktikat e mira Evropiane, të cilat sigurojnë shërbime kuantitative dhe kualitative, të qëndrueshme me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

PËRMBAJTA

1	Hyrje	5
2	Sfidimi i biznes planeve rregullatore	7
3	Aplikimi i inflacionit	8
4.	analiza e prodhimit, faturimit dhe konsumatorët.....	9
4.1	Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, humbur dhe ujit të faturuar në m ³ dhe numrit të konsumatorëve.....	10
5.	analiza e shpenzimeve operative	12
5. 1	Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza	13
5.2	Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza.....	14
6.	Shumat e Faturimit dhe arkëtimit në vlerë monetare	15
6.1.	Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza.....	16
6.2	Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza.....	17
6.3.	Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza	18
6.4.	Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza	19
7.	Investimet kapitale	20
7.1.	Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake.....	21
7.2.	Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake	22
7.3.	Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët	23
7.4.	Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët	24
7.5.	Investimet në përtëritjen e infrastrukturës.....	25
8.	KONKLuzionET	28

Akronimet dhe shkurtesat

BPRR	Biznes Plane Rregullatore
FE	Kompania Rajonale e Ujit Bifurkacioni (Ferizaj)
GJA	Kompania Rajonale e Ujit Radoniqi (Gjakova)
GJI	Kompania Rajonale e Ujit Hidromorava (Gjilan)
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
MIT	Kompania Rajonale e Ujit Mitrovica (Mitrovicë)
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NjPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujit Hidrodrini (Pejë)
PR	Kompania Rajonale e Ujit Prishtina (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujit Hidroregjioni Jugor (Prizren)
ZRRUK	Zyra Rregullatore për Ujësjetllës dhe Kanalizim

1 HYRJE

Ky raport pasqyron të dhënat e performances së shtatë (7) kompanive regjionale të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të cilën vlerësohet përmbushja e caceve të përcaktuara me procesin rregullatorë gjatë nëntë mujorit të parë të vitit 2012 dhe jep një pasqyrë të përgjithshme të sektorit për periudhën e shikuar.

Raporti është përgatit mbi bazën e të dhënave të përcaktuara si cak me procesin rregullatorë 2012-2014 për nëntë (9) mujorin e parë të vitit 2012 të akorduara mes kompanive dhe ZRRUK-ut dhe të dhënave të realizuara gjatë të njëjtës periudhë të këtij viti, si dhe të dhënave historike të nëntë mujorit të parë të vitit 2011 për krahasim.

Qëllimi i këtij raporti është i trefishtë:

- (i) Të jepet informacion për trendin e treguesve operativ dhe financiar të KRU-ve dhe në veçanti për shkallen e investimeve kapitale të realizuara për këtë periudhë kohore.
- (ii) Të krahasohen treguesit e punës së KRU-ve me objektivat e përcaktuara të procesit tariforë të periudhës së shikuar dhe në rast të shmangieve të mëdha në këtë plan të mundësohet ndërmarrja e veprimeve me kohë për të ndryshuar, ose korrigjuar trendet e tilla.
- (iii) Të vlerësohen efektet e tarifave të reja të aplikuara nga fillimi i këtij vitit gjer në fund të periudhës së shikuar .

Ky raport i paraprin raportit vjetorë si pasqyrë përmbledhëse për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara për tërë vitin 2012, për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi.

Vërejtje- Shënim;

1. Të dhënat e KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë, përveç të dhënave që lidhen me qytetin e Mitrovicës dhe regionin në tërësi janë marrë parasysh edhe të dhënat për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Për sqarim të mëtejshëm duhet theksuar se pjesa jugore e qytetit dhe regjioni përfshin të dhënat operative dhe financiare të furnizimit të ujit me pakicë, ndërsa të dhënat për pjesën veriore përfshijnë kostot e prodhimit dhe të furnizimit të ujit me shumicë. Kjo qasje do të vazhdojë të prezantohet si e tillë edhe në të ardhmen gjatë raportimeve tona për këtë kompani.

2. Të dhënat e KRU “Hidrodrini” sh. a. Pejë janë preliminare për faktin se kompania ishte në proces së bartjes dhe regjistrimit të shënimeve të veta nga softueri i vjetër në të riun, te i cili mund të ketë ndonjë gabim eventual. Raporti përmballës vjetor do të përmbaj të dhëna të sakta edhe për këtë kompani.

2 SFIDIMI I BIZNES PLANEVE RREGULLATORE

Edhe pse në raportin përmbyllës tarifar 2012-2014 është përshkruar në detaje mënyra se si ZRRUK ka sfiduar BPRR-t e kompanive gjatë procesit të përcaktimit të tarifave, kemi konsideruar të arsyeshme që edhe në këtë raport të bëjmë një përshkrim të shkurtër se si ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më eficientë në shërbimet e tyre ndaj konsumatorëve të vet.

Parimi bazë i procesit rregullatorë ka qenë qëndrueshmëria financiare për kompanitë dhe shërbime më të mira për konsumatorët e shërbyer, të cilat kemi shpresuar se do të arrihen me tarifa të arsyeshme, për këtë arsye kemi përcaktuar caqe sfiduese për kompanitë që të përmirësojnë performancën e përgjithshme, dhe atë:

1. Fuqimisht jemi të mendimit se shpenzimet operative janë shumë më të larta se sa ato do të duhej të ishin, dhe roli i tyre ngritët pasi që kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa. Gjatë diskutimeve tona me disa nga përfaqësuesit e kompanive kemi kërkuar nga ta që kostot e tyre të larta t'i përafrojnë me kostot mesatare të sektorit.
2. Ne besojmë se KRU-të kanë një shkallë të lartë të humbjeve komerciale, shumë kycje të pa ligjshme dhe faturimi jo i kënaqshëm të cilat duhet të jenë fokus i menaxhmenteve për t'i minimizuar ato, ose sjellë në relacione optimale .
3. Edhe pse performanca në arkëtimin e të ardhurave është duke u përmirësuar, vendosmërisht jemi të mendimit se përmirësimet janë shumë të ulëta në krahasim me atë se sa ato do duhej të ishin, edhe pse ne kemi qenë të kujdesshëm për të mos qenë shumë ambicioz tek këta tregues themelorë për procesin rregullatorë 2012-2014.

Prandaj, ZRRUK do të;

- kryej monitorimin e rregullt (siç po bëjmë me këtë raport) për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara me procesin aktual rregullator,
- mos përmbushja e objektivave do të ketë si pasojë veprimet legjitime të ZRRUK-ut për të rishikuar tarifat e vitit të ardhshëm, të raportojë gjetjet tek aksionari në cilësinë e pronarit të kompanive dhe te palët tjera të interesit.

3 APLIKIMI I INFLACIONIT

Të gjitha të dhënat financiare të shprehura në Euro janë të përshtatura me nivelin e çmimeve të mesatares së nëntë mujorit të vitit 2012. Këtë të dhënë DFTRR/ZRRUK e ka nxjerr nga publikimet e bëra të Entit të Statistikave të Kosovë për mesataren e Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë për periudhën kohore të shikuar.

Pasi të dhënat historike të vitit 2011 kanë përfshirë të dhënat e 9 mujorit e parë të këtij viti, atëherë vlerat nominale janë indeksuar me indeksin 1.01831 i cili paraqet raportin në mes shkallës mesatare të Indeksit të Çmimeve të Konsumit nëntë mujor për vitin 2012 (124.2) dhe shkallës mesatare të Indeksit të Çmimeve të Konsumit për nëntë mujorin e vitit 2011 (121.96).

Për vlerat e aprovuara nga ZRRUK indeksimi është bërë me indeksin e çmimit të konsumit prej 1.02306 i cili paraqet raportin në mes normës mesatare të Indeksit të Çmimeve të Konsumit për periudhën nëntë mujore të vitit 2012 (124.2) dhe vlerës së Indeksit të Çmimeve të Konsumit për muajin Qershor 2011 (121.4) pasi që vlerat e aprovuara të marra nga biznesi rregullator kanë pasur për bazë çmimet e mesit të vitit 2011.

4. ANALIZA E PRODHIMIT, FATURIMIT DHE KONSUMATORËT

Analiza në vazhdim ofron të dhëna për këto kategori operative të shërbimeve të ujit të shprehura në metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (iv) dhe numrin e konsumatorëve.



Tabela Nr. 1 Pasqyra e të dhënave sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar, përqindjen e përmbushjes së caqeve dhe vlerësimi përfundimtarë




Emri i Kompanisë	Të dhënat operative	Njësia matëse	Historike 9m 2011	Aprovuara 9m 2012	Realizuara nga KRU-të 9m 2012	%	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Uji i prodhuar	m ³	34,543,568	36,108,921	33,719,988	-6.62%	Negativ
	Uji i humbur	m ³	18,929,231	18,086,783	17,875,112	-1.17%	Pozitiv
	Uji i faturuar	m ³	15,614,337	18,022,139	15,844,876	-12.08%	Negativ
	Konsumatorët	Nr	87,671	100,703	92,653	-7.99	Negativ
Hidroregjioni Jugor (PZ)	Uji i prodhuar	m ³	15,329,697	15,628,934	14,677,007	-6.09%	Negativ
	Uji i humbur	m ³	9,688,280	9,740,009	8,927,560	-8.34%	Pozitiv
	Uji i faturuar	m ³	5,641,418	5,888,926	5,749,447	-2.37%	Negativ
	Konsumatorët	Nr	33,490	33,137	35,434	6.93%	Pozitiv
Hidrodrini (PE)	Uji i prodhuar	m ³	20,785,397	21,404,363	20,212,910	-5.57%	Negativ
	Uji i humbur	m ³	14,565,049	14,661,303	12,957,347	-11.62%	Pozitiv
	Uji i faturuar	m ³	6,220,349	6,743,060	7,255,563	7.60%	Pozitiv
	Konsumatorët	Nr	34,522	32,123	33,415	4.02%	Pozitiv
Mitrovica (MIT)	Uji i prodhuar	m ³	13,328,204	16,737,704	13,174,238	-21.29%	Negativ
	Uji i humbur	m ³	6,965,326	9,533,325	6,765,192	-29.04%	Pozitiv
	Uji i faturuar	m ³	6,362,878	7,204,379	6,409,046	-11.04%	Negativ
	Konsumatorët	Nr	21,794	23,061	25,880	12.23%	Pozitiv
Radoniqi (GJA)	Uji i prodhuar	m ³	15,283,103	15,389,900	13,627,936	-11.45%	Negativ
	Uji i humbur	m ³	10,695,649	10,558,598	9,096,833	-13.84%	Pozitiv
	Uji i faturuar	m ³	4,587,454	4,831,302	4,531,103	-6.21%	Negativ
	Konsumatorët	Nr	27,345	28,750	28,107	-2.24%	Negativ
Bifurkacioni (FE)	Uji i prodhuar	m ³	5,179,460	4,830,922	4,292,482	-11.15%	Negativ
	Uji i humbur	m ³	3,390,366	2,331,495	2,989,256	28.21%	Negativ
	Uji i faturuar	m ³	1,789,094	2,499,427	1,303,226	-47.86%	Negativ
	Konsumatorët	Nr	16,976	17,593	16,837	-4.30%	Negativ
Hidromorava (GJI)	Uji i prodhuar	m ³	5,386,358	5,590,897	5,628,704	0.68%	Pozitiv
	Uji i humbur	m ³	3,188,777	3,061,958	3,422,177	11.76%	Negativ
	Uji i faturuar	m ³	2,197,581	2,528,939	2,206,527	-12.75%	Negativ
	Konsumatorët	Nr	19,085	18,911	19,516	3.20%	Pozitiv
SEKTORI	Uji i prodhuar	m ³	109,835,786	115,691,640	105,333,265	-8.95%	Negativ
	Uji i humbur	m ³	67,422,677	71,123,470	62,033,477	-12.78%	Pozitiv
	Uji i faturuar	m ³	42,413,110	44,568,170	43,299,788	-2.85%	Negativ
	Konsumatorët	Nr	240,883	254,276	251,842	-0.96%	Negativ

4.1 Paraqitja grafike e ujit të prodhuar, humbur dhe ujit të faturuar në m³ dhe numrit të konsumatorëve

Të dhënat e tabelës Nr. 1 janë paraqitur grafikisht përmes grafikoneve të cilat mundësojnë krahasimin më të lehtë vizual të të dhënave historike, të dhënave aprovuara dhe atyre me të dhënat të cilat KRU-të i kanë realizuar gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2012.

Për të pasur një pasqyrë se cila është përqindja e konsumatorëve sipas KRU-ve, ne i kemi paraqitur këto përmes grafikoneve, ku vërehet se KRU “Prishtina” kontribuon në këtë total prej 37%, ndërsa KRU “Bifurkacioni” prej 7%, dhe kështu me radhë për secilën KRU veç e veç.





5. ANALIZA E SHPENZIMEVE OPERATIVE

Sikurse u cek edhe më lartë, gjatë procesit tarifor, ZRRUK ka kërkuar nga KRU-të të jenë më të kujdesshëm me kostot e drejtpërdrejta operative dhe ka kërkuar që të njëjtat të ulën deri në optimumin e arsyeshëm.

Për të qenë më konsekuent në aprovimin e shpenzimeve operative, të cilat kanë ndikim direkt në lartësinë e tarifës, ne kemi përdorur metodën e regresionit për ato kompani që kanë pas kosto operative mbi kostot optimale të disa kompanive të tjera, të cilat janë marrë për bazë gjatë krahasimit të dhënave të tilla dhe për këtë arsye kemi konsideruar se kjo është metoda më e arsyeshme dhe më transparente për reduktimin e shpenzimeve operative nga KRU-të të cilat konsiderohen me shpenzime jo shumë racionale.

Të dhënat e shpenzimeve operative që do të paraqiten në këtë raport janë kategorizuar konform udhëzimeve të kontabilitetit rregullator, fillimisht duke i ndarë shpenzimet operative për ujë dhe kanalizim.

Sipas UKRR, shpenzimet operative për ujë i kemi paraqitur të ndara në tri kategori:

- shpenzimet operative në resurse dhe trajtim
- shpenzimet operative në distribuim, dhe
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Ndërkaq, shpenzimet operative për ujëra të zeza, janë të ndara në 4 kategori, dhe atë:

- shpenzimet operative në grumbullimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e ujërave të zeza
- shpenzimet operative në trajtimin e llumit
- shpenzimet operative në aktivitete biznesore

Për detaje më të hollësishme se cilat zëra të shpenzimeve operative futen në kategoritë përkatëse, mund të konsultoheni me Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator, të cilin mund ta gjeni të publikuar në ueb faqen zyrtare të ZRRUK (www.wwro-ks.org).



5. 1 Shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza

Në këtë tabelë janë të paraqitura shpenzimet operative për ujë dhe ujëra të zeza për secilën KRU, duke paraqitur shpenzimet operative historike për nëntë (9) mujorin e parë vitit 2011, ato të aprovuara nga ZRRUK si dhe ato të realizuara nga KRU për të njëjtën periudhë të vitit 2012, shkallën e përmbushjes së caceve në % dhe vlerësimi përfundimtarë për këtë periudhë kohore.

Tabela Nr. 2 Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza në €

Emri i Kompanisë	Zërat e shpenzimeve operative	Njësia monetare	Historike 9m 2011	Aprovuara nga ZRRUK 9m 2012	Realizuara nga KRU 9m 2012	%	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	5,675,191	4,122,510	5,255,384	27.48%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	175,686	151,846	176,044	15.94%	Negativ
	Totali	€	5,850,877	4,274,356	5,431,428	27.07%	Negativ
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,764,746	1,750,951	1,878,838	7.30%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	89,665	96,246	99,977	3.88%	Negativ
	Totali	€	1,854,411	1,847,197	1,978,815	7.13%	Negativ
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,142,319	1,181,806	1,005,963	-14.88%	Pozitiv
	Ujëra të Zeza	€	61,181	64,303	57,335	-10.84%	Pozitiv
	Totali	€	1,203,500	1,246,109	1,063,298	-14.67%	Pozitiv
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	1,325,762	1,256,890	1,361,437	8.32%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	88,601	124,784	132,000	5.78%	Negativ
	Totali	€	1,414,363	1,381,674	1,493,437	8.09%	Negativ
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,316,294	1,184,891	1,410,773	19.06%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	122,772	61,615	105,035	70.47%	Negativ
	Totali	€	1,439,066	1,246,506	1,515,808	21.60%	Negativ
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	499,906	552,554	519,681	-5.95%	Pozitiv
	Ujëra të Zeza	€	46,764	40,916	45,184	10.43%	Negativ
	Totali	€	546,670	593,470	564,865	-4.82%	Pozitiv
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	775,850	686,031	794,673	15.84%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	74,501	58,109	81,825	40.81%	Negativ
	Totali	€	850,351	744,140	876,498	17.79%	Negativ
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	12,500,068	10,735,633	12,226,749	13.89%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	659,170	597,819	697,400	16.66%	Negativ
Totali i përgjithshëm sektorial		€	13,159,238	11,333,452	12,924,149	14.04%	Negativ

5.2 Paraqitja grafike e shpenzimeve operative për ujë dhe ujëra të zeza



6. SHUMAT E FATURIMIT DHE ARKËTIMI NË VLERË MONETARE

Të dhënat për faturim dhe arkëtim në vlerë monetare do të paraqiten po ashtu në formë tabelore, në mënyrë që më lehtë të krahasohen rezultatet e arritura gjatë nëntë muorit të vitit 2012 me ato të aprovuara nga ZRRUK për të njëjtën periudhë kohore, sipas procesit rregullator të përcaktimit të tarifave të viteve 2012-2014.

Edhe këto të dhëna do të paraqiten sipas shërbimeve të ofruara; veç për shërbimet e ujit dhe veç për shërbimet e kanalizimit dhe pastaj të përmbledhura do të paraqiten për çdo kompanie veç e veç dhe për sektorin si tërësi përgjatë periudhës së shikuar 9 mujore të vitit 2012 dhe për krahasime do të pasqyrohen edhe të dhënat e tilla të realizuara për 9 mujorin e vitit 2011 si të dhëna historike.

Konform politikave tarifore, të cilat janë publikuar nga ZRRUK në Mars të vitit 2011, faturimi dhe arkëtimi nga tarifa fikse dhe volumetike i atribuohet shërbimeve të ujësjellësit, ndërsa tarifa volumetrike për kanalizim i atribuohet si e vetme shërbimeve të ujërave të zeza. Ky kategorizim do të paraqitet edhe në tabelat e mëposhtme.

Në secilën tabelë të faturimit dhe të arkëtimit janë të vendosura dy kolona të cilat përcaktojnë shkallën e përmbushjes së cakut. Kolona e emëruar si “%” paraqet përqindjen e realizimit të cakut, duke i krahasuar të dhënat e realizuara nga KRU-të me ato të aprovuara nga ZRRUK për periudhën nëntë mujore të vitit 2012. Dhe në fund të secilës tabelë ekziston kolona e veçantë e cila në mënyrë tekstuale tregon nëse KRU-të përkatëse kanë treguar performancë “Pozitive” apo “Negative”.



6.1. Shuma e faturimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur faturimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të nëntë mujorit të parë të vitit 2011, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të për periudhën e nëntë mujorit të parë të vitit 2012.

Tabela Nr. 3 Pasqyra e të dhënave të shumave të faturimit për ujë dhe ujërave të zeza në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Të dhënat e faturimit për:	Njësia monetare	Historike 9m 2011	Aprovuara nga ZRRUK 9m 2012	Realizuara nga KRU 9m 2012	%	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	8,070,598	9,829,883	9,218,011	-6.22%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	660,474	963,192	833,180	-13.50%	Negativ
	Totali	€	8,731,072	10,793,075	10,051,191	-6.87%	Negativ
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	2,278,324	2,750,502	2,506,356	-8.88%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	240,596	334,918	290,974	-13.12%	Negativ
	Totali	€	2,518,920	3,085,420	2,797,330	-9.34%	Negativ
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,884,762	2,192,255	2,140,422	-2.36%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	184,466	262,193	245,187	-6.49%	Negativ
	Totali	€	2,069,228	2,454,448	2,385,609	-2.80%	Negativ
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	1,385,329	1,885,608	1,371,343	-27.27%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	194,864	331,013	291,027	-12.08%	Negativ
	Totali	€	1,580,193	2,216,621	1,662,370	-25.00%	Negativ
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,872,950	2,200,559	2,125,960	-3.39%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	160,578	234,865	217,661	-7.33%	Negativ
	Totali	€	2,033,528	2,435,424	2,343,621	-3.77%	Negativ
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	740,786	1,082,765	821,369	-24.14%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	123,551	321,852	166,074	-48.40%	Negativ
	Totali	€	864,337	1,404,617	987,443	-29.70%	Negativ
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	936,045	1,178,669	1,004,103	-14.81%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	144,759	235,340	187,616	-20.28%	Negativ
	Totali	€	1,080,804	1,414,009	1,191,719	-15.72%	Negativ
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	17,168,794	21,120,241	19,187,564	-9.15%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	1,709,288	2,683,373	2,231,719	-16.83%	Negativ
Totali i përgjithshëm sektorial		€	18,878,082	23,803,614	21,419,283	-10.02%	Negativ

6.2 Paraqitja grafike e faturimit për ujë dhe ujëra të zeza





6.3. Shuma e arkëtimit për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Në këtë tabelë është paraqitur arkëtimi për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në vlerë monetare, për të dhënat historike të nëntë mujorit të parë të vitit 2011, ato të aprovuara nga ZRRUK dhe të realizuara nga KRU-të për periudhën e nëntë mujorit të parë të vitit 2012 .

Tabela Nr. 4 Shumat e arkëtimit për shërbimet e ujit në vlerë monetare

Emri i Kompanisë	Faturimi për shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Historike 9m 2011	Aprovuara nga ZRRUK 9m 2012	Realizuara nga KRU 9m 2012	%	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	5,707,735	7,337,168	6,229,028	-15.10%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	467,105	733,103	499,333	-31.89%	Negativ
	Totali	€	6,174,840	8,070,271	6,728,361	-16.63%	Negativ
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	1,645,916	2,002,172	1,778,765	-11.16%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	173,812	246,410	206,505	-16.19%	Negativ
	Totali	€	1,819,728	2,248,582	1,985,270	-11.71%	Negativ
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,163,158	1,576,663	1,126,214	-28.57%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	113,841	198,074	129,009	-34.87%	Negativ
	Totali	€	1,276,999	1,774,737	1,255,223	-29.27%	Negativ
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	776,620	1,171,185	716,098	-38.86%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	109,241	222,311	151,618	-31.80%	Negativ
	Totali	€	885,861	1,393,496	867,716	-37.73%	Negativ
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	1,335,797	1,671,690	1,613,980	-3.45%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	114,525	179,028	165,243	-7.70%	Negativ
	Totali	€	1,450,322	1,850,718	1,779,223	-3.86%	Negativ
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	464,825	735,641	474,314	-35.52%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	77,526	221,497	94,476	-57.35%	Negativ
	Totali	€	542,351	957,138	568,790	-40.57%	Negativ
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	731,001	924,877	719,093	-22.25%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	113,049	186,294	134,430	-27.84%	Negativ
	Totali	€	844,050	1,111,171	853,523	-23.19%	Negativ
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	11,825,052	15,419,396	12,657,492	-17.91%	Negativ
	Ujëra të Zeza	€	1,169,099	1,986,717	1,380,614	-30.51%	Negativ
Totali i përgjithshëm sektorial		€	12,994,151	17,406,113	14,038,106	-19.35%	Negativ

6.4. Paraqitja grafike e arkëtimit për ujë dhe ujëra të zeza



7. INVESTIMET KAPITALE

ZRRUK me aprovimin e tarifave të reja për periudhën afatmesme 2012-2014 ka paraparë që të ndërmerren investime të konsiderueshme nga të gjitha kompanitë e ujësjellësit, këto investime janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit, të cilat nëse realizohen do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë.

Sipas UKRR-s, investimet kapitale janë klasifikuar si investime në **shërbimet ujësjellësit dhe shërbimet e kanalizimit**, të cilat klasifikohen më tej:

I. Investimet në shërbimet e ujësjellësit më pastaj janë ndarë në:

- Investime në resurse dhe trajtim të ujit
- Investime në distribuim
- Investime në aktivitete biznesore

II. Kurse investimet në shërbimet e ujërave të zeza janë ndarë në:

- Investime në grumbullimin e ujërave të zeza
- Investime në trajtimin ujërave të zeza
- Investime në trajtimin dhe derdhjen e llumit
- Investime në aktivitete biznesore

Më pastaj, investimet në asetet e ujësjellësit dhe kanalizimit janë ndarë në: **asetet e infrastrukturës dhe ato të jo-infrastrukturës**

Investimet kapitale në **Asetet Infrastrukturore** janë të ndara në investime të cilat bëhen për qëllime të përtëritjes infrastrukturës dhe në investime të rritjes së infrastrukturës. Këto Investime karakterizohen si investime në asete nëntokësore siç janë: gypat, pusetat, digat, rezervuarët nëntokësore, kanalet e ujit etj.

Investimet kapitale në **Asetet Jo-Infrastrukturore** bëjnë pjesë të gjitha asetet mbitokësore siç janë: fabrikat për trajtimin e ujit, ndërtesat administrative, mjetet transportuese, pajisjet për zyrë etj. Ky grup i investimeve më pastaj kategorizohet në investime të mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes së jo-infrastrukturës.

Për t'u njoftuar më në detaje për këto kategorizime mund të gjenden shpjegime në UKRR të cilat janë të publikuara në webfaqen zyrtare të ZRRUM.

Në tabelat e mëposhtme do të paraqiten investimet sipas kategorive të lartcekura për të gjitha KRU-të.




7.1. Shumat e Investimeve kapitale nga financimet vetanake

Në tabelën e më poshtme paraqiten shumat e investimeve kapitale me financim nga burimet vetanake të kompanive për kategorinë e shërbimeve të ujësjellësit dhe të shërbimeve për ujëra të zeza. Më këtë bëhet krahasimi i shumave të investimeve kapitale të aprovuara nga ZRRUK me ato të realizuara nga KRU-të për periudhën e nëntë mujorit të parë të vitit 2012.

Tabela Nr. 5. Shumat e Investimeve kapitale prej burimeve vetanake për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në €

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Aprovuara nga ZRRUK	Realizuara nga KRU 9m 2012	% e realizimit	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	4,321,828	479,147	11.09%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	568,143	7,482	1.32%	Negativ
	Totali	€	4,889,971	486,629	9.95%	Negativ
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	271,163	87,392	32.23%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	117,338	4,123	3.51%	Negativ
	Totali	€	388,501	91,515	23.56%	Negativ
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	282,068	24,158	8.56%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	19,298	0	0.00%	Negativ
	Totali	€	301,366	24,158	8.02%	Negativ
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	0	0	!	!
	Ujëra të zeza	€	104,429	0	0.00%	Negativ
	Totali	€	104,429	0	0.00%	Negativ
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	305,716	63,269	20.70%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	104,429	0	0.00%	Negativ
	Totali	€	410,145	63,269	15.43%	Negativ
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	88,733	32,762	36.92%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	152,219	6,498	4.27%	Negativ
	Totali	€	240,952	39,260	16.29%	Negativ
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	204,171	39,131	19.17%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	88,841	0	0.00%	Negativ
	Totali	€	293,012	39,131	13.35%	Negativ
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	5,473,679	725,859	13.26%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	1,154,697	18,103	1.57%	Negativ
Totali i përgjithshëm sektorial		€	6,628,376	743,962	11.22%	Negativ

7.2. Paraqitja grafike e të dhënave për investime kapitale vetanake






7.3. Shumat e investimeve kapitale të financuara nga donatorët

Në këtë tabelë paraqiten të dhënat e shumave të aprovuara dhe realizuara nga financimet e donatorëve të cilët kanë qenë pjesë të planifikimit të projekteve për realizim të investimeve kapitale për shërbimet e ujit dhe të ujërave të zeza për periudhën e 9 mujorit të parë të vitit 2012. Krahasimi i të dhënave të tilla pasqyron shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara për këtë periudhë kohore, të cilat epen në % me vlerësimin përfundimtarë.

Tabela Nr. 6. Shumat e investimeve kapitale të aprovuar dhe realizuar nga donatorët për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza gjatë 9 mujorit të parë të vitit 2012

Emri i kompanisë	Investimet në shërbimet përkatëse	Njësia monetare	Aprovuara nga ZRRUK	Realizuara nga KRU 9m 2012	% e realizimit	Vlerësimi përfundimtar
Prishtina (PR)	Ujë	€	4,337,454	163,617	3.77%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	1,383,439	0	0.00%	Negativ
	Totali	€	5,720,893	163,617	2.86%	Negativ
Hidroregjioni jugor (PZ)	Ujë	€	3,114,390	203,179	6.52%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	636,950	0	0.00%	Negativ
	Totali	€	3,751,340	203,179	5.42%	Negativ
Hidrodrini (PE)	Ujë	€	1,565,288	0	!	Negativ
	Ujëra të zeza	€	1,688,056	0	!	Negativ
	Totali	€	3,253,344	0	0.00%	Negativ
Mitrovica (MIT)	Ujë	€	8,359,714	0	!	Negativ
	Ujëra të zeza	€	2,685,544	0	!	Negativ
	Totali	€	11,045,258	0	0.00%	Negativ
Radoniqi (GJA)	Ujë	€	115,095	170,562	148.19%	Pozitiv
	Ujëra të zeza	€	7,673	0	!	Negativ
	Totali	€	122,768	170,562	138.93%	Pozitiv
Bifurkacioni (FE)	Ujë	€	560,128	44,152	!	Negativ
	Ujëra të zeza	€	613,217	0	!	Negativ
	Totali	€	1,173,345	44,152	3.76%	Negativ
Hidromorava (GJI)	Ujë	€	641,461	0	!	Negativ
	Ujëra të zeza	€	0	0	!	!
	Totali	€	641,461	0	0.00%	Negativ
Të dhënat sektoriale	Ujë	€	18,693,530	581,510	3.11%	Negativ
	Ujëra të zeza	€	7,014,879	0	0.00%	Negativ
Totali i përgjithshëm sektorial		€	25,708,409	581,510	2.26%	Negativ

7.4. Paraqitja grafike e të dhënave për investimet kapitale nga donatorët




7.5. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës

Është e njohur nga praktika e gjertanishme se të gjitha asetet kanë një jetëgjatësi të caktuar, prandaj për ato alokohet pjesa përkatëse e mjeteve financiare në mënyrë që në fund të jetëgjatësisë së tyre të blihen asete të reja dhe të zëvendësohen ato të vjetrat. Karakteristikë e kontabilitetit rregullator është se asetet të cilat gjenden nën nivelin e tokës (asetet infrastrukturore) nuk amortizohen, por atyre u njihet shpenzimi për përtëritjen e infrastrukturës në shumën e aprovuar me procesin rregullator. ZRRUK ka konstatuar se kjo kategori e investime ka ndikim direkt në nivelin e shërbimeve.

Shuma e duhur e mjeteve financiare të nevojshme për përtëritje efektive infrastrukturore është vështirë të përcaktohet, por pas një periudhe të arsyeshme kohore dhe me të dhëna të mjaftueshme për shpenzime dhe për performancë është e mundur që të ndërlidhet shkalla e shpenzimeve me përmirësimin apo përkeqësimin e shërbyeshmërisë së infrastrukturës.

Në mungesë të të dhënave të besueshme për performancën e menaxhimit të aseteve në shqyrtimin tarifar 2012-2014, shuma e mjeteve për investime në përtëritjen e infrastrukturës është përcaktuar si një shpenzim vjetor prej të paktën 10% të vlerës së BRA për rrjetin shpërndarës të furnizimit me ujë dhe 10% të vlerës së BRA të sistemit të grumbullimit të ujërave të zeza për shërbimet e ujërave të zeza. Po ashtu si kriter tjetër në shumën e mjeteve të përtëritjes së infrastrukturës ka qenë për të siguruar një nivel minimal të rritjes reale të tarifave e për të siguruar sinjale pozitive për investitorët (4% në vit për ujë dhe 10% për ujëra të zeza). Ky proces është i ilustruar në figurën mëposhtme.



Konform këtij procesi, për të gjitha KRU-të janë bërë rregullimet e nevojshme për të pasqyruar shumat e përtërimitjes së infrastrukturës, siç edhe do të paraqiten në tabelat në vijim për 9 mujorin e këtij viti.

Tabela Nr.8. Investimet në përtërimitjen e infrastrukturës për ujë

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 9m 2012		Aprovuara nga ZRRUK 9m 2012		Realizuara nga KRU 9m 2012		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione
PRISHTINA	1,318,26	2,129,895	2,102,67	2,129,895	108,510	163,617	Negativ	Negativ
HIDROREGJIONI JUGOR	131,903	1,129,502	131,903	1,129,502	5,690	0	Negativ	Negativ
HIDRODRINI	38,366	448,885	201,624	448,885	2,870	0	Negativ	Negativ
MITROVICA	0	1,381,185	0	1,381,185	0	0	!	Negativ
RADONIQI	7,673	115,099	291,148	115,099	19,162	123,665	Negativ	Pozitiv
BIFURKACIONI	0	329,950	55,741	329,950	7,580	440,152	Negativ	Pozitiv
HIDROMORAVA	0	27,624	115,675	27,624	0	0	Negativ	Negativ
TOTALI	1,496,20	5,562,139	2,898,76	5,562,139	143,812	727,434	Negativ	Negativ

Tabela Nr.9. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për ujëra të zeza

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 9m 2012		Aprovuara nga ZRRUK 9m 2012		Realizuar nga KRU 9m 2012		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione
PRISHTINA	290,049	1,076,557	546,110	1,076,557	6,990	0	Negativ	Negativ
HIDROREGJIONI JUGOR	76,733	613,860	90,486	613,860	0	0	Negativ	Negativ
HIDRODRINI	19,183	602,350	19,183	602,350	0	0	Negativ	Negativ
MITROVICA	0	0	104,433	0	0	0	Negativ	Negativ
RADONIQI	0	7,673	104,433	7,673	0	0	Negativ	Negativ
BIFURKACIONI	1,151	344,675	150,690	344,675	4,686	0	Negativ	Negativ
HIDROMORAVA	0	0	86,803	0	0	0	Negativ	Negativ
TOTALI	387,115	2,645,115	1,102,13	2,645,115	11,676	0	Negativ	Negativ

Tabela Nr.10. Investimet në përtëritjen e infrastrukturës për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza

Emri i Kompanisë	Planifikuara nga KRU 9m 2012		Aprovuara nga ZRRUK 9m 2012		Realizuar nga KRU 9m 2012		Vlerësimi përfundimtar	
	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione	Vetanake	Donacione
PRISHTINA	1,608,31	3,206,452	2,648,78	3,206,452	115,500	163,617	Negativ	Negativ
HIDROREGJIONI JUGOR	208,636	1,743,362	222,389	1,743,362	5,690	0	Negativ	Negativ
HIDRODRINI	57,549	1,051,235	220,807	1,051,235	2,870	0	Negativ	Negativ
MITROVICA	0	1,381,185	104,433	1,381,185	0	0	Negativ	Negativ
RADONIQI	7,673	122,772	395,581	122,772	19,162	123,665	Negativ	Pozitiv
BIFURKACIONI	1,151	674,624	206,430	674,624	12,266	440,152	Negativ	Negativ
HIDROMORAVA	0	27,624	202,478	27,624	0	0	Negativ	Negativ
TOTALI	1,883,32	8,207,254	4,000,90	8,207,254	155,488	727,434	Negativ	Negativ

8. KONKLuzionet

Nga të dhënat e këtij raporti periodik shihet se në përgjithësi kompanitë veç e veç dhe sektori në përgjithësi ka dështuar në përmbushjen e objektivave të përcaktuara gjatë këtij 9 muhori të këtij viti të cilat kanë qenë të lidhur ngushtë me procesin rregullatorë të vitit 2012.

Njohurit tona për sektorin të cilin e kemi në kompetencë për ta rregulluar na konfirmojnë bindjen tonë se kompanitë në përgjithësi Planet Rregullatore të Bizneseve po i bëjnë duke u bazuar ma tepër në vullnetin e mirë të tyre për të treguar synime më efikiente se sa janë mundësit reale, të cilat ndërlihen me një mori faktorësh dhe ndikuesish të cilat janë brenda kompanive dhe jashtë tyre në ambientin ku po veprojnë.

Duke marr parasysh përvojën tonë në këtë sektorë duhet theksuar se kompanitë ende nuk janë adaptuar me kushtet dhe rrethanat e tregut e mjedisit ku veprojnë dhe se një vendosshmeri dhe këmbëngulësi ma e madhe e gjithë faktorëve që ndikojnë në këtë shërbim do të sillte rezultate domosdoshmërisht ma të mira.

Menaxhmentet e kompanive duhet të angazhohen fuqishëm për eliminimin e pengesave në rrugët e afarizmit të tyre, për të kërkuar pastaj edhe mbështetjen e aktorëve të tjerë për ta lehtësuar, mbështet punën e tyre e cila lidhet me përmbushjen e objektivave të përcaktuar me procesin rregullatorë të këtij viti.

Mos përmbushja e objektivave të përcaktuar me procesin rregullatorë të viteve 2012-2014, për çdo vit që nënkupton edhe për vitin 2012 do të këtë reperkusione të cilat do të sanksionohen nga rregullatori gjatë vlefshmërisë së tarifave të vitit të ardhshëm.

ZRRUK do të monitorojë ngushtë të dhënat e përcaktuar me këtë raport edhe gjatë pjesës së mbetur të këtij viti biznesore për të cilat do të editojë edhe një raport vjetor me të cilin do të përcillen trendet e afarizmit të kompanive, duke bërë vlerësimin e shkallës së përmbushjes së obligimeve të marra me procesin rregullatorë të tarifave për vitin 2012.